




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA VENDORE KORÇË



Nr. 5123/6 Prot.

Korçë, më 20.12.2023

Lënda: Kërkesë për publikim.

**NJËSISË ADMINISTRATIVE VRESHTAS**

Brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të garantuar nga Ligji nr.111/2018 „ Për Kadastrën“, Ligjit nr. 20 dt.05.03.2020 “Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1040/2020 “ Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë ka miratuar Vendimet për legalizimin e ndërtimeve pa leje në favor të subjekteve të poshtëshënuar.

Në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që “ *Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa , zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së*” dhe “ *Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Proçedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së*”, për sa më sipër kërkojmë:

**Publikimin për afatin 30 (tridhjetë) ditor në ambientet e Institucionit tuaj së listës së mëposhtme të subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara.**

**Çdo subjekt i cili ka pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin e legalizimit është i lutur ti drejtohet strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.**

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTORI

Stavri Mushka

Stavri

Digitally signed by  
Stavri Mushka  
Date: 2023.12.19



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Korçë  
Date: 2023/12/21 08:39:38 +02'00'

Korçë, www.ashk.gov.al, email: info@ashk.gov.al



